



# SFIDAT DHE NEVOJAT E PUNONJËSIT TË NJËSISË PSIKO-SOCIALE NË SHKOLLA



# PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJE</b> .....	<b>3</b>
<b>2. METODOLOGJIA</b> .....	<b>3</b>
<b>3. DEMOGRAFIA</b> .....	<b>4</b>
<b>4. GJETJET</b> .....	<b>5</b>
4.1. VËSHTIRËSITË DHE SFIDAT QË HASEN NË PUNËN E PËRDITSHME .....	5
4.2. SFIDAT E LIDHURA ME FORCIMIN DHE NGRITJEN E KAPACITETEVE PROFESIONALE .....	14
4.3. SUGJERIME TË PROFESIONISTËVE LIDHUR ME KAPËRCIMIN E SFIDAVE/VËSHTIRËSIVE TË LIDHURA ME PROBLEMATIKAT E PUNËS SË PËRDITSHME .....	16
4.4. SUGJERIME TË PROFESIONISTËVE LIDHUR ME AFTËSIMIN E TYRE PROFESIONAL .....	19
<b>5. REKOMANDIMET</b> .....	<b>22</b>

## 1. HYRJJE

Në fillim të vitit 2020, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) dhe Terre des hommes (Tdh) hartuan, botuan dhe shpërndanë Manualin e Punës për Punonjësit e Njesisë Psiko-Sociale në Shkollë, i cili shërben si një mjet orientues në punën e këtyre punonjësve. Po në këtë vit, nevoja për rritjen e numrit të punonjësve të këtyre njësive, u mbështet edhe nga Urdhri i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 593 për rekrutimin shtesë, proces i cili u realizua duke sjellë prurje profesionistësh të rinj në këtë detyrë.

Me synim mbështetjen e profesionistëve në detyrën e tyre si punonjës të Njesisë Psiko-Sociale në Shkollë, Tdh, përveç organizimit të trajnimeve dyditore me tematika që mbështeten në Manualin e Punës së Punonjësit Psiko-Social (maj – qershor 2021), organizoi edhe grupe të fokusuara diskutimi me qëllim mbledhjen e informacionit më të thelluar mbi nevojat konkrete të punonjësve lidhur me punën e tyre në këto njësi.

Në fund të procesit u përgatit ky raport, i cili ka si qëllim informimin e aktorëve përgjegjës për plotësimin e nevojave për ndihmë dhe aftësim të mëtijshëm të profesionistëve, dhe i cili mund të përdoret edhe si bazë për hartimin e një plani ndërhyrjeje në të ardhmen.

Raporti përmban seksione të dedikuara për çdo profil profesional (psikologu dhe punonjësi social) me gjetjet kryesore nga diskutimet në grup dhe sygjerime të ardhura nga vetë profesionistët lidhur me përmirësimin e rolit dhe performancës së tyre në punë. Në fund raporti mbyllet me një përmbledhje të shkurtër të përmbajtjes së tij, në formën e rekomandimeve.

## 2. METODOLOGJIA

Mbledhja e të dhënave u realizua në periudhën maj – qershor 2021, duke u kombinuar me trajnimet për profesionistët mbi Manualin e Punonjësit të Njesisë Psiko-sociale. Kështu, në fundin e ditës së parë të çdo trajnimi dyditor, 10 – 12 profesionistët e përzgjedhur për secilën kategori (psikolog – punonjës social) u organizuan në grupe të veçanta, të cilat u drejtuan/mbështetën nga dy eksperte të fushës, përkatësisht Znj. Rudina Rama për punonjësit socialë dhe Znj. Blerta Bodinaku për psikologët. Sikurse dhe trajnimet, edhe grupet e fokusuara u realizuan virtualisht, përmes platformës Zoom, mundësuar nga Childhub.

10 – 12 punonjësit që morën pjesë në diskutime u zgjedhën në mënyrë rastësore bazuar vetëm në dy kërkesa të nevojshme: profili profesional dhe vitet e eksperiencës në këtë detyrë, duke mundësuar që në çdo grup i fokusuar diskutimi të kishte kombinimin e duhur

të përfaqësimit nga kategoria e të sapoardhurve (0 – 1 vite punë), atyre me eksperiencë të konsoliduar (2 – 5 vite pune) dhe atyre me eksperiencë të gjatë (mbi 5 vite pune).

Diskutimet e drejtuara nga ekspertet u bazuan në një udhërrëfyes të përgatitur paraprakisht, duke synuar mbledhjen e informacionit mbi vështirësitë e perceptuara nga ana e punonjësve në kryerjen e detyrës së tyre, shkaqet e këtyre vështirësive, si mund të tejkalohen ato, kush mund të ndihmojë dhe si, cilat janë nevojat për forcimin e kapaciteteve, cilat kanë qenë eksperiencat në këtë drejtim, çfarë duhet ndryshuar apo përmirësuar dhe kush e si mund të ndihmojë për këtë.

Në fund të të gjithë procesit, rreth 130 punonjës socialë dhe psikologë morën pjesë në 14 grupet e diskutimit të realizuara, duke pasur mundësinë të ndanin informacion dhe shprehnin opinionet e tyre lidhur me çështjet e ngritura. Të gjitha seancat janë dokumentuar përmes mbajtjes së shënimeve dhe janë regjistruar në Zoom, për të lehtësuar procesin e mbledhjes, analizimit dhe interpretimit të informacionit.

### 3. DEMOGRAFIA

- **Punonjësit socialë**

Në total morën pjesë 72 punonjës socialë, nga të cilët: 12 nga Tirana, 3 nga Kukësi, 3 nga Tropoja, 8 nga Fieri, 7 nga Vlora, 9 nga Elbasani, 8 nga Korça, 3 nga Dibra, 8 nga Durrësi, 7 nga Berati dhe 4 nga Gjirokastra.

Nga pjesëmarrësit rezultoi se 24 prej tyre kishin një përvojë pune në shkollë që shkonte nga 3 – 15 vite, dhe 48 me përvojë pune nga 0 – 12 muaj. 19 punonjës socialë mbulonin vetëm shkolla 9-vjeçare, 10 vetëm shkolla të mesme, 30 mbulonin shkolla 9-vjeçare dhe të mesme dhe 13 punonjës socialë mbulonin më shumë se tre shkolla.

- **Psikologët**

Në total morën pjesë 55 psikologë, nga të cilët: 11 nga Tirana, 3 nga Kukësi, 3 nga Tropoja, 5 nga Fieri, 4 nga Vlora, 9 nga Elbasani, 4 nga Korça, 2 nga Dibra, 6 nga Durrësi, 3 nga Berati, 2 nga Lushnja dhe 3 nga Shkoda.

Nga pjesëmarrësit rezultoi se 28 prej tyre kishin një përvojë pune në shkollë që shkonte nga 3 – 15 vite, 25 me përvojë pune nga 0 – 12 muaj dhe 3 psikologë me përvojë mbi 15 vite punë. 27 psikologë mbulonin 1 shkollë, 16 psikologë mbulonin 2 – 3 shkolla, 9 psikologë mbulonin 4 – 5 shkolla dhe 3 psikologë mbulonin 6 – 7 shkolla. Nga këta psikologë, 3 prej tyre mbulonin 1 – 3 shkolla të mesme të bashkuara, të cilat përfshijnë të

gjitha ciklet parauniversitare, nga parashkollori tek shkolla e mesme. Ngarkesa e këtyre psikologëve shkonte nga 12 – 42 shkolla, duke përfshirë shkollat në vartësi.

## 4. GJETJET

### 4.1. Vështirësitë dhe sfidat që hasen në punën e përditshme

#### 4.1.1. Punonjësi social

- **Paqartësia dhe konfuzioni lidhur me rolin e punonjësit social**

Një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve në fokus grupe shprehën në mënyrë të përsëritur shqetësimin e tyre për konfuzionin e rolit të punonjësit social me atë të psikologut, në sistemin e arsimit parauniversitar, që raportohet se lidhet kryesisht me:

- Vendosjen/prezencën e dy figurave profesionale, ku rolet dhe funksionet e secilit nuk janë krejtësisht të rregulluar në aspektin institucional dhe të cilët shpesh, kryejnë detyra të njëjta dhe të mbivendosura. Edhe pse së fundmi janë hartuar dokumente orientuese dhe rregulluese, kjo ende mbetet për t'u përmirësuar;
- Nivelin e ulët të njohjes së profesionit dhe paqartësitë mbi këtë rol nga profesionistët e aktorët e tjerë si drejtuesit, mësuesit, nxënësit, prindërit, etj. Shpesh, roli dhe kryerja e detyrës së punonjësit social ndikohet ndjeshëm nga niveli i informacionit, perceptimit dhe mbështetjes nga drejtuesit dhe mësuesit në shkolla. Gjithashtu, nxënësit dhe komuniteti i prindërve, shpesh përpiqen që të shmangin shërbimin për shkak të stigmës dhe ndonjëherë edhe të bullizmit nga bashkëmoshatarët. Niveli i ulët i informacionit për rolin dhe funksionin e punonjësit social ndikon drejtpërsëdrejti në menaxhimin e rasteve dhe çfarë është më e rëndësishme në mirëqenien e fëmijëve. Pavarësisht rrethanave dhe pengesave për të kryer detyrën, përgjegjësia në rastet e problemeve i ngarkohet më së shumti punonjësve të këtij shërbimi;
- Fillimin vite më parë të funksionimit si shërbimi psiko-social, vijimi më pas për disa vite si shërbimi psikologjik dhe së fundmi përsëri, si shërbimi psiko-social me të dy figurat profesionale. Kryesisht, kjo situatë ka ndikuar në pasjen e një numri më të madh psikologësh në raport me punonjësit socialë, dhe kjo vlerësohet se ka zbehur dhe vështirësuar kuptueshmërinë e rolit dhe funksionit të punonjësit social;
- Përvojën e pamjaftueshme të profesionistëve në shkolla, për të punuar në ekipe shumëdisiplinore. Të punuarit në ekipe shumëdisiplinore kërkon me patjetër njohje dhe respektim të rolit dhe kompetencave të secilit profesionist, përcaktim të qartë të detyrave, vullnet për komunikim, ndërveprim dhe bashkëpunim;
- Në shkollat ku ka vetëm punonjës social ose vetëm psikolog, atyre u kërkohet që të kryejnë të dy rolet. Gjatë vitit të fundit ka një rritje dhe përmirësim të ndjeshëm

në numrin e këtyre dy profesionistëve. Por, në të njëjtën kohë, në nivel kombëtar ka praktika ku në shkolla ka vetëm punonjës social ose vetëm psikolog, të cilët duhen të kryejnë të dy funksionet;

- Punonjësit socialë shprehen se mungesa e ngritjes së urdhrit të punonjësit social nuk ka ndikuar për mirë në profilin dhe formësimin e figurës së tyre profesionale. Ata theksojnë se ngritja dhe mirëfunksionimi i urdhrit do të shërbejë në promovimin dhe forcimin e figurës së tyre profesionale. Por paralelisht, punonjësit socialë e pranojnë se përgjegjësia kryesore për promovimin dhe qartësinë e rolit u takon vetë profesionistëve.

- **Standardizimi dhe njësimi i dokumenteve të punës**

Punonjësit socialë raportojnë se pjesën më të madhe të dokumenteve, formateve, instrumenteve të ndryshme të punës (vlerësimet, planet e ndërhyrjes) me të cilat ata punojnë i kanë strukturuar dhe formuluar vetë. Brenda por edhe ndërmjet rajoneve, ata i kanë shkëmbyer këto mes tyre dhe janë përpjekur vazhdimisht t'i përmirësojnë dhe t'i zhvillojnë. Së fundi vërehen iniciativa që synojnë institucionalizimin dhe njësimin e dokumenteve dhe praktikave, por këto duken iniciativa lokale dhe jo fort të qarta për profesionistët. Gjatë fokus grupeve rezultoi se modeli i përgatitur nga profesionistët në Korçë vlerësohet si një praktikë mjaft e mirë dhe se edhe të tjerët dëshirojnë që të përdorin këtë model.

Një pjesë e punonjësve socialë treguan se së fundmi kishin marrë pjesë në një seminar/trajnim një ose dyditor në lidhje me “dosjen e punës”, të cilin e vlerësuan si shumë të dobishëm, por kohëzgjatjen e trajnimit si të pamjaftueshme. Ata theksuan rëndësinë e zhvillimit të një cikli trajnimesh ku të diskutohen dhe shtjellohen dokumentet dhe elementet përkatëse, për të siguruar të njëjtën kuptueshmëri dhe mënyrë përdorimi nga të gjithë profesionistët.

Një nevojë tjetër e evidentuar është njësimi i instrumenteve të vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe i instrumenteve të hartimit të planeve individuale të ndërhyrjes. Komisionet e vlerësimit përdorin instrumente të ndryshme vlerësimi si ai i ICF-së<sup>1</sup>, formate të ofruara nga organizatat e fushës së aftësive të kufizuara, apo formate që profesionistët mund t'i kenë përshtatur, pasi i kanë marrë nga burime të ndryshme në internet, etj.

Punonjësit socialë kanë si detyrë funksionale përgatitjen dhe prezantimin e temave të shumëllojshme në seancat e informimit me nxënësit, bazuar në një plan paraprak. Nga fokus grupet vërehet lehtësisht përkushtimi dhe angazhimi i tyre për të përgatitur materiale të pasura, të strukturuar, tërheqëse, miqësore dhe të përshtatura për fëmijët

---

<sup>1</sup> International Classification of Functioning

dhe të rinjtë. Pjesën më të madhe të informacionit për përgatitjen e tyre ata e sigurojnë nëpërmjet internetit, por nuk kanë akses në faqe apo platforma të njohura dhe të kontrolluara për profesionistët, me përjashtim të platformës [www.childhub.org](http://www.childhub.org) dhe së fundmi [www.sociale.al](http://www.sociale.al).

- **Mospërputhja ndërmjet kërkesave dhe resurseve**

Një pjesë e konsiderueshme e punonjësve socialë raportojnë se nuk kanë një zyrë fikse dhe të përshtatshme, nuk kanë internet, kompjuter, printer dhe materiale të ndryshme për të kryer detyrat funksionale. Ata përdorin kompjuterët personalë ose shërbime me pagesë për të përgatitur materialet, për të printuar apo arkivuar dokumentet e punës apo procese të tjera. Kjo situatë ndikon në një masë të konsiderueshme në performancën në punë, vendosjen e marrëdhënieve me nxënësit, prindërit, mësuesit, por krijon edhe një mjedis stresues dhe lodhës.

Mungesa e udhërrëfyesve apo protokolleve për të punuar me fëmijët që braktisin shkollën, me fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët në situatë dhune, të rinjtë që përdorin substanca, ata që kanë varësi nga teknologjia dhe interneti, bullizmin, sjelljet antisociale, etj, është po ashtu diçka që i pengon këta profesionistë në realizimin me cilësi të detyrave të tyre.

Sikurse theksuam edhe më lart, pjesë e detyrave të punonjësit social është edhe realizimi i seancave të informimit të nxënësve për çështje dhe tema të ndryshme sipas një kalendarit pune, por edhe bazuar në nevojat që mund të paraqiten në shkollë. Por, kjo kërkesë nuk është shoqëruar me një plan dhe parashikim të qartë se si dhe kur duhen kryer seancat e informimit. Për shembull, të parashikohet që seancat e informimit do të zhvillohen gjatë orëve mësimore të mëngjesit x dhe y, apo që një ditë në javë nxënësit duhet të qëndrojnë pas mësimet, etj. Si rrjedhojë, punonjësit socialë, për të përmbushur këtë detyrë, janë të detyruar që t'i "lypin" orë mësuesve të ndryshëm (kryesisht të mëngjesit shoqërore) që sipas mundësive t'u krijojnë hapësira për të kryer seancat e informimit.

Në disa rajone punonjësit socialë vazhdojnë të mbulojnë një numër të madh shkollash ose shkolla që janë të shpërndara në qytet dhe në fshat. Kur punojnë në shkolla rurale, sidomos në zona të thella, ata raportojnë edhe vështirësi në lidhje me transportin publik. Kjo situatë ndikon dhe dobëson ndërhyrjen dhe zgjidhjen në kohë të problemeve, cilësinë e marrëdhënies dhe bashkëpunimin me nxënësit, mësuesit dhe drejtuesin e shkollës, vështirëson punën me grupmosha të ndryshme që shkojnë nga 6 në 18 vjeç, hartimin dhe zbatimin e një plani sipas nevojave të nxënësit, etj.

Janë treguar edhe disa raste të pakta ku punonjësi social gjatë orarit të punës nuk lejohet që të dalë jashtë shkollës, për shembull për menaxhimin e rastit, vizita në familje, apo takime me aktorët e ndryshëm në institucione dhe komunitet.

Një pjesë e punonjësve socialë përfshihen në aktivitete që nuk lidhen me rolin dhe kompetencat e tyre profesionale. Raportohen raste kur drejtuesit e shkollës për të plotësuar nevoja të ndryshme, i angazhojnë punonjësit socialë si mësues ndihmës, për të zëvendësuar mësuesit që mungojnë apo për punë të ndryshme administrative që nuk lidhen me funksionin e tyre. Shpesh, këto angazhime kërkojnë shumë kohë dhe energji, janë të vështira për t'u kryer dhe shpërqendrojnë punonjësit socialë nga rolet dhe funksionet e tyre, si dhe krijojnë kushte për stres në punë dhe lodhje.

- **Niveli i pamjaftueshëm i informacionit mbi kuadrin ligjor dhe rregullator**

Krahas formateve dhe instrumenteve të ndryshme të vlerësimit, vërehen edhe paqartësi në lidhje me kuadrin ligjor dhe rregullator si ligjet, VKM-të, udhëzimet, strategjitë e planet e veprimit, standardet, protokollet e punës, manualet dhe udhërrëfyesit. Punonjësit socialë raportojnë se informacioni në lidhje me këto dokumente është i pakët dhe i paqartë dhe se ata kanë nevojë të udhëzohen dhe të pajisen me këto dokumente. Ndërkohë, punonjësit e rinj raportojnë se teorikisht ata e kanë këtë informacion, pasi ai ka qenë kriter përzgjedhës për rekrutimin, por ata kanë nevojë të thellojnë njohuritë mbi interpretimin dhe mënyrën e zbatimit të tyre.

Edhe pse së fundmi janë hartuar e miratuar një sërë udhëzimesh e dokumentesh, shpesh ato nuk zbatohen pasi mungojnë modalitetet e zbatimit të tyre.

Punonjësit socialë lavdërojnë Manualin e Punës, por një pjesë e tyre mendojnë se pavarësisht vlerës së shtuar për shërbimin psiko-social, ka ende çështje që lidhen me rolin dhe detyrat e tyre, që janë përshkruar në mënyrë të përgjithshme dhe detajimi i të cilave do t'i ndihmonte ata.

Në disa rajone është zhvilluar një cikël trajnimesh në lidhje me dosjen dhe dokumentimin e punës, por ai vlerësohet si i pamjaftueshëm. Punonjësit socialë theksojnë se dokumentet e punës do t'i preferonin të shoqëruara me një manual shpjegues për plotësimin dhe dokumentimin, pasi seksione të ndryshme janë kuptuar në mënyra të ndryshme dhe si rrjedhojë grumbullohen të dhëna të ndryshme dhe inkoherente, të cilat shpesh mund të çojnë në formulime të pasakta të problemit dhe në strategji ndërhyrje inefficente.

- **Bashkëpunimi ndërsektorial**

Punonjësit socialë shprehën nevojën për të qenë të informuar në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë që kanë aktorët në nivel lokal për sa i përket referimit bazuar në nevoja dhe shërbimeve sociale që ofrohen në komunitet nga institucionet dhe organizatat publike dhe jo publike (si shërbimet për fëmijët me aftësi të kufizuara, për çështjet e dhunës, për të rinjtë, shërbime të tjera të specializuara, etj.) Kjo do të ndihmonte ndjeshëm për



referimin e rasteve në shërbimin e duhur dhe bazuar në nevoja. Për këtë do të ndihmonte edhe pajisja me hartën e shërbimeve sociale.

Një pjesë e punonjësve socialë raportuan nevojën për t'u prezantuar dhe njohur me administratën vendore, punonjës të mbrojtjes së fëmijëve dhe specialistë të tjerë të drejtorive të shërbimeve sociale pranë bashkive apo njësive administrative.

Si pjesë e grupeve teknike ndërdisiplinore punonjës socialë, sidomos ata që janë të rinj në punë raportuan se e kanë shumë të nevojshme që të marrin më shumë informacion, njohuri dhe mbështetje për zhvillimin e aftësive profesionale për të bashkëpunuar me efikasitet dhe efektivitet.

- **Çështje të tjera të ndryshme**

Klasifikimi dhe trajtimi i diferencuar i stafit psiko-social për sa i përket kategorisë së pagës dhe kohëzgjatjes së lejes vjetore. Punonjës socialë shprehën njëzëri shqetësimin për diferencimin në mënyrë të papritur dhe të paarsyetuar si rrjedhojë e klasifikimit të tyre si staf administrativ i cili ka ndikuar edhe në përcaktimin e nivelit të pagës dhe të lejes vjetore të tyre.

U raportuan disa raste të mësuesve që kanë një nivel të ulët të referimit të rasteve të identifikuar të nxënësve me probleme dhe një lloj rezistence prej tyre për të qenë të hapur dhe bashkëpunues.

Një sfidë që e listuan disa prej punonjësve socialë, ishte numri i kufizuar i punonjësve socialë si supervizorë, duke shprehur njëkohësisht mirënjohjen dhe vlerësimin për mbështetjen e supervizorëve psikologë. Në mënyrë të përsëritur ata theksuan nevojën e vendosjes së një supervizori për punonjës socialë dhe një supervizori për psikologët. Një çështje tjetër që u diskutua kishte të bënte me pëlqimin e informuar nga nxënësit dhe prindërit. Dilema lidhej me momentin kur duhet marrë pëlqimi, në fillim të vitit shkollor nga të gjithë nxënësit dhe prindërit, apo rast pas rasti, apo në ndonjë formë apo mënyrë tjetër alternative. Profesionistët ndanë përvoja të ndryshme sesi kishin vepruar, por kjo u konsiderua ende një çështje e hapur dhe e cila ka nevojë të zgjidhet.

#### **4.2.2. Psikologu**

- **Përkufizimi dhe njohja e rolit të psikologut**

Shumica e psikologëve të përfshirë në grupet e diskutimit evidentuan si problem qendror konfuzionin në lidhje me rolin e psikologut në sistemin arsimor parauniversitar. Ky konstatim përfshin:

- a) diferencimin e pamjaftueshëm mes roleve të psikologut dhe të punonjësit social. Kjo ka sjellë që në disa raste, psikologu ose punonjësi social të konsiderohet si punonjësi i vetëm psiko-social në shkollë, me pretendimin se secili prej tyre mund të mbulojë i vetëm të dy rolet dhe funksionet;
- b) rritjen e ngarkesës në punë të psikologut në shkollë, duke mbuluar, kryer apo duke u kujdesur për funksione të tjera, si ai i punonjësit social, oficerit të sigurisë apo mësuesit ndihmës. Pavarësisht nëse është detyrë që i takon atij, psikologut i vijnë kërkesa si nga shkolla ashtu edhe nga jashtë saj, ku i kërkohet kryerja e punës, zgjidhja apo arritja e një rezultati. Gjithashtu, mosnjohja me rolin e psikologut, shpesh e mbingarkon psikologun me punë, veçanërisht në rastet e raportimeve, edhe kur kjo mund t'i takojë kolegëve të tjerë;
- c) konfuzionin e vetë psikologëve në lidhje me kërkesat ndaj tyre si dhe kuadrin ligjor dhe atë mbështetës që rregullon aktivitetin e psikologëve në shkolla. Për shembull, ka konfuzion mes rolit të psikologut shkollor dhe rolit të këshilluesit të shkollës. Këto janë dy profile të ndryshme, të cilat janë të vështira të mbulohen nga një psikolog i vetëm, veçanërisht duke pasur parasysh numrin e lartë të nxënësve që mbulon një psikolog i vetëm. Në vijim, Urdhri i Psikologut ka nxjerrë një udhëzim që i ndalon psikologët shkollorë të ofrojnë këshillim në shkollë, ndryshe nga sa parashikon Manuali për Shërbimet Psiko-Sociale në Shkolla, i hartuar nga Tdh në bashkëpunim me MASR;
- d) mosnjohjen, refuzimin, ose keqpërdorimin e psikologut shkollor nga mësuesit dhe drejtuesit e institucionit arsimor. Mosnjohja e mjaftueshme e rolit të psikologut dhe rëndësisë së tij në shkollë, shpesh shoqërohet me kërkesa që nuk kanë të bëjnë me funksionet e psikologut në shkollë, si p.sh. zëvendësimi i mësuesve që mungojnë, përfshirja në administrimin e provimeve, vlerësimi i dosjeve të mësuesve për lëvizje paralele, etj. Po ashtu, moskuptimi i rëndësisë së disa prej funksioneve të psikologëve nga drejtuesit në nivel qendror, rajonal apo institucional, ka bërë që psikologët të privohen nga mundësia për të pasur *kohë të dedikuar* për aktivitetet e planifikuara dhe të funksionojnë kryesisht në varësi të orëve dhe hapësirave të lira që mund të krijohen rastësisht dhe pavarësisht planeve të punës;
- e) mosnjohjen dhe/ose refuzimin e rolit të psikologut nga prindërit, gjë që rezulton në bashkëpunim të dobët dhe mosdhënien e shërbimit ose dhënien e një shërbimi të pjesshëm.

- **Numri i lartë i referimeve për mbrojtjen e nxënësve**

Rastet e referimeve për mbrojtjen e të miturve janë rritur shumë duke i shkaktuar psikologut më shumë stres, shpesh edhe frikë dhe lodhje. Kjo ka mundësuar bashkëpunimin me institucione të ndryshme si p.sh. komisariati i policisë duke bërë që psikologu i shkollës të jetë më efikas. Por kjo përfshirje është shumë e shpeshtë për psikologun si person. Ngarkesa e shtuar në punë redukton kapacitetin e psikologut për

të punuar me masën dhe numrin e madh të nxënësve, si dhe rrit presionin psikologjik për shkak të përfshirjes në çështje me natyrë ligjore.

- **Mospërputhja midis detyrave të psikologut shkollor dhe statusit të tij**

Psikologët në arsim trajtohen si punonjës administrate, ndërkohë që detyrat e tyre i tejkalojnë funksionet administrative dhe qëndrojnë më pranë arsimit, edukimit dhe kujdesit shëndetësor. Në një masë të madhe, psikologët evidentuan një sërë kufizimesh në trajtimin e tyre, të cilat burojnë nga përcaktimi jo i plotë i statusit të psikologut në arsim. Kufizimet dhe konfuzioni në trajtim, ashtu siç u evidentuan nga psikologët në grupet e diskutimit, përshijnë pagën e ulët, lejen vjetore që nuk përkon me praninë apo mospraninë e nxënësve në shkollë, mungesën e trajtimit financiar në lidhje me udhëtimet dhe transportin, njohjen e vjetërsisë në punë, mungesën e autonomisë në ushtrimin e aktivitetit të tyre, etj.

- **Baza ligjore e paplotë ose e paqartë në lidhje me rregullimin e pozicionit, funksionimit dhe mbrojtjes së psikologut shkollor**

- a) Psikologët raportojnë se shpesh nuk e kanë të qartë se nga cili institucion varen. Për shembull, edhe pse parashikohet sigurimi i bazës materiale të dedikuar për stafet psiko-sociale, shpesh kjo mbetet e paplotësuar si pasojë e paqartësisë nëse është detyrë e bashkive apo ZVA-ve;
- b) Nuk ka bazë ligjore apo strategji që të garantojnë mbrojtjen dhe mbajtjen e psikologëve të punësuar brenda sistemit, në rastet kur shkollat që ata mbulojnë, rrezikojnë të mbyllen nga ulja e numrit të nxënësve;
- c) Nuk zbatohet ligji për ngritjen në detyrë të drejtuesit të shërbimit psiko-social;
- d) Nuk është përcaktuar baza ligjore për uljen e ngarkesës në punë të psikologëve kur ata kryejnë funksione të dyfishta (supervisor, drejtues shërbimi, etj.)

- **Numri i lartë i shkollave për psikolog**

Edhe pse me Urdhrin Nr. 593 të MASR është reduktuar në mënyrë të ndjeshme numri i nxënësve për psikolog, në mjaft raste numri i ulët i nxënësve në shkollat rurale dhe ato të zonave të largëta, bën që një psikolog të duhet të mbulojë një numër të madh shkollash me qëllim që të plotësojë numrin e normuar të nxënësve. Shpërndarja në shkolla të ndryshme, në disa raste në distanca të konsiderueshme, shoqërohet me një sërë problemesh:

- a) pamundësi për t'u përgjigjur në kohë reale ndaj nevojave të nxënësve, problemeve që lindin varësisht nga situatat;
- b) përplasje rolesh dhe detyrash që buron nga nevoja për t'iu përgjigjur në mënyrë të menjëhershme situatës problematike pa praninë e psikologut dhe që zakonisht kryhet nga mësuesit apo drejtuesit e institucionit. Ky skenar mund të shoqërohet

me konflikt midis psikologut dhe drejtuesit/mësuesit, izolim të psikologut dhe fragmentim të informacionit të disponueshëm për psikologun;

- c) me qëllim plotësimin e numrit, shpesh psikologët duhet të mbulojnë nivele të ndryshme të arsimit parauniversitar, nga arsimi fillor, arsimi i mesëm i ulët, arsimi i mesëm i lartë dhe në disa raste edhe arsimin parashkollor. Kjo gjë përkthehet në sfida thelbësore për formimin e vazhduar dhe atë specifik dhe rrjedhimisht për praktikën profesionale të psikologut, i cili duhet t'u përgjigjet nevojave dhe sfidave të ndryshme që paraqesin këto grupmosha;
- d) humbje e madhe e kohës dhe kosto e lartë financiare e pambuluar.

- **Mungesa e testeve të validuara dhe standardizuara për vlerësimin psikologjik**

Psikologët raportojnë se mungesa e testeve të validuara dhe standardizuara vështirëson një sërë procesesh të punës së tyre, nga vlerësimi, hartimi i planeve të trajtimit, raportimet ndaj palëve të treta apo komunikimi me prindërit. Testet e validuara janë teste të përkthyera dhe të përshtatura nga pikëpamja gjuhësore dhe kulturore, ndërsa standardizimi përfaqëson procesin përmes të cilit gjenerohen vlerat e normuara që i japin kuptim pikëzimit në një kontekst të caktuar. Përdorimi në praktikë i testeve psikometrike kërkon që testet t'i përmbushin të dyja kriteret. Testet e kërkuara më shpesh nga psikologët në grupet e diskutimit përfshijnë:

- a) testet e inteligjencës;
- b) testet e vlerësimit të vështirësive të të nxënit;
- c) teste të posaçme për aftësinë e kufizuar;
- d) testet për arritjet akademike;
- e) testet vlerësuese të statusit mendor dhe emocional të fëmijëve dhe adoleshentëve, të tilla si testet për ankthin, depresionin, vetëvlerësimin;
- f) testet për sjelljen e rrezikshme ndaj vetes dhe të tjerëve;
- g) testet për zhvillimin e identitetit;
- h) testet për orientimin në karrierë.

- **Mungesa e dokumenteve të unifikuara dhe standardizuara të përdorshme nga të gjithë psikologët në shkolla**

Psikologët raportojnë se shpenzojnë shumë kohë duke hartuar në mënyrë individuale formate dokumentesh, të cilat shpeshherë duhen riformuluar në përputhje me ndryshimin e kërkesave ose për nevoja të tjera. Dokumente të tilla përfshijnë:

- a) formate vlerësimi;
- b) formate raportimi ndaj institucioneve të ndryshme (ZA, NJMF, Policia e Shtetit, etj.);
- c) formate për hartimin e planeve mujore apo vjetore;
- d) plane vjetore të unifikuara për kategori të ndryshme;

- e) plane afatgjata, si p.sh. plane trevjeçare të unifikuara për grupe psikologësh në rrethe të ndryshme.

- **Mungesa e protokolleve të posaçme për situata problemore specifike**

Mungesa e protokolleve ngadalëson proceset e vlerësimit dhe të ndërhyrjes si dhe i ekspozon palët (nxënësit, psikologët, familjet, institucionin apo komunitetin) ndaj rreziqeve të shtuara për zgjidhje të gabuara, për rënie në kontakt me ligjin, konflikte, neglizhencë, etj. Në mënyrë të përsëritur u evidentua mungesa e protokolleve për zgjidhjen e:

- a) situatave të rrezikut për vetëvrasje apo të rrezikut ndaj të tjerëve;
- b) rasteve që kanë të bëjnë me përdorimin e substancave narkotike ose psikotrope;
- c) abuzimit seksual (në mjediset e shkollës apo jashtë saj);
- d) situatave me implikime ligjore (vjedhjeve, trafikimit, shpërndarjes së substancave narkotike apo psikotrope, shfrytëzimit, abuzimit kibernetik, përfshirjes në grupe kriminale, etj.);
- e) situatave të dhunës në familje;
- f) braktisjes së shkollës;
- g) ekstremizmit të dhunshëm;
- h) çështjeve të etikës dhe garantimit të konfidencialitetit në kushtet e punës me të mitur.

- **Zgjidhja e pamjaftueshme e çështjeve të aftësisë së kufizuar në shkolla**

Psikologët raportojnë një numër problemesh që lidhen me mbulimin e pamjaftueshëm të nevojave të fëmijëve me AK dhe presionin e shtuar mbi psikologët në lidhje me këtë problematikë;

- a) jo në të gjitha shkollat ka mësues ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- b) jo në të gjitha rastet, mësuesit ndihmës kanë formimin e përshtatshëm. Edhe pse kriteret e pranimit të mësuesve ndihmës përfshijnë formimin e tyre të specializuar në pedagogji, jo të gjithë kanë arritur ta kryejnë/përfundojnë këtë profilizim;
- c) mungesa e testeve të posaçme për vlerësimin e arritjeve akademike të fëmijëve me aftësi të kufizuara ose vështirësi në të nxënë;
- d) provime mature të padiferencuara për nxënësit me aftësi të kufizuara. Në provimet e fundit të maturës, vetëm disa ZA kishin hartuar teste të posaçme;
- e) kërkesa ndaj psikologut të shkollës për të zhvilluar terapi zhvillimi me këta nxënës, pavarësisht kohëzgjatjes së terapisë dhe numrit të lartë të nxënësve me AK.

- **Mungesa e një sistemi referimi të konfirmuar, konsoliduar dhe zyrtarizuar**

Me përjashtim të Njërive për Mbrojtjen e Fëmijëve, shërbimeve sociale të mbuluara nga bashkitë dhe shërbimeve shëndetësore publike, psikologët shkollorë hasin vështirësi në identifikimin e shërbimeve të tjera private, shoqatave apo organizatave ku mund të

referojnë nxënësit me probleme apo nevoja specifike. Psikologët raportojnë se u mungon informacioni për shërbimet ekzistuese, u mungon garancia për cilësinë dhe besueshmërinë e shërbimeve që propozojnë, u mungon njohja e pikave të kontaktit ose mundësia për referime në këto shërbime, si dhe rrezikojnë të ballafaqohen me paragjykimin e prindit/mësuesit/drejtuesit, si palë në një proces potencialisht korruptiv. Gjithashtu, shpeshherë, referimi nuk bëhet në rrugë institucionale por në mënyrë private nga psikologu i shkollës.

Në vijim, psikologët konstatojnë pamjaftueshmërinë e strukturave të posaçme për garantimin e mbrojtjes së fëmijëve si një pengesë madhore në ushtrimin e plotë dhe të sigurtë të funksioneve të tyre.

- **Mungesa e mjediseve dhe bazës materiale**

Njëzëri, psikologët raportojnë si një ndër problemet qendrore, mungesën e mjediseve të përshtatshme për garantimin e të gjithë gamës së shërbimeve psikologjike, si dhe mungesën e bazës materiale që mundëson cilësinë e shërbimit. Kjo përfshin mungesën e:

- a) një zyre të dedikuar posaçërisht për shërbimin psikologjik;
- b) pajisjeve të nevojshme të tilla si dollap me çelës për dokumentacionin konfidencial (apo kasafortë), grilave të dritareve, kondicioner, kompjuter, printer;
- c) kancelarisë (letër, bojë printeri, lapsa me ngjyra, dosje, etj.)

## **4.2. Sfidat e lidhura me forcimin dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale**

### **4.2.1. Punonjësi social**

Edukimi i vazhduar është motoja për zhvillimin dhe sigurimin e performancës në punë për të gjitha profesionet. Forcimi dhe rritja e kapaciteteve profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke filluar nga puna autodidakte dhe deri tek pjesëmarrja në seminare, konferenca profesionale dhe shkencore, përfshirja në studime, supervizimi, pjesëmarrja në trajnime, etj.

Gjatë sesioneve të fokus grupeve, punonjësit socialë raportuan çështje të larmishme në lidhje me trajnimet:

- mungesa e urdhrit profesional i ka vendosur në një situatë të paqartë, në raport me psikologët, në lidhje me kriteret dhe kërkesat për edukimin e vazhduar;
- nuk mbajnë mend raste ku zyrtarisht të jenë konsultuar apo t'ju jetë kërkuar mendim në lidhje me fusha, tema, apo çështje specifike për të cilat ata kanë nevojë të rrisin aftësitë dhe kompetencat e tyre profesionale;

- shprehin falënderimin dhe vlerësimin për trajnimet e zhvilluara deri më tani, por në shumicën e rasteve trajnimet nuk janë realizuar bazuar në nevojat e tyre, por sipas perceptimit dhe prioriteteve të ofruesit të trajnimit;
- disa raportojnë pjesëmarrjen në trajnime për tema të njëjta dhe të përsëritura. Për një periudhë të caktuar kohe mbizotëron vetëm një temë e caktuar dhe më pas për vite me radhë ka një pauzë të gjatë edhe pse mund të ketë mjaft nevojë;
- punonjësit socialë me përvojë të gjatë theksojnë se aktualisht ka një rënie të numrit të trajnimeve të zhvilluara krahasuar me më parë. Ndërsa punonjësit e rinj bëjnë apel për nevojën e pjesëmarrjes në sa më shumë trajnime;
- trajnimet janë të fragmentarizuara dhe orientohen nga prioritetet e organizatave lokale në rajone të ndryshme;
- një pjesë vlerësojnë si shumë të rëndësishme, aktuale dhe të dobishme, trajtimin e temave si ekstremizmi i dhunshëm, menaxhimi i rastit, hartimi i planit të punës për fëmijët me aftësi të kufizuara, çështjet e dhunës me bazë gjinore, trajnimin për dosjen e punës, etj.;
- disa nga temat për të cilat ata shfaqën interes ishin: dosja e punës, kuadri ligjor dhe rregullator, çështjet etike, përdorimi i teknologjisë dhe programeve për hedhjen dhe përpunimin e të dhënave, varësia e fëmijëve nga teknologjia dhe interneti, abuzimi seksual, aftësia e kufizuar, zgjidhja e konfliktit, çrregullimet e të nxëniet, menaxhimi i ankthit, orientimi dhe këshillimi i karrierës, ndërtimi i marrëdhënieve me nxënësit dhe prindërit, puna në ekip, nxitja dhe motivimi drejt shkollës, menaxhimi i rastit, përdorimi i të dhënave për të lobuar dhe advokuar, etj.
- punonjësit socialë parashtrojnë nevojën për të zhvilluar trajnime bazuar në praktika, diskutime dhe trajtime rastesh konkrete, prezantimin nga ana e tyre të një shtate apo rasti specifik dhe më pas diskutimin dhe trajtimin e tij në grup, nën drejtimin e trajnuesit;
- ata vlerësojnë dhe lavdërojnë nivelin e lartë të përgatitjes teorike të trajnerëve, por pritshmëritë e tyre janë të orientuara drejt zgjidhjeve praktike në rrethanat dhe kushtet e mungesës së burimeve dhe alternativave për zgjidhje;
- ata shprehën vlerësimin për Terres des Home, Save the Children, World Vision, Fakultetin e Shkencave Sociale, Ndihamoni Jetën dhe MEDPAK për çështjet e aftësisë së kufizuar, etj.;
- punonjësit socialë shprehën interes të veçantë për të marrë pjesë në konferenca profesionale dhe shkencore, por pjesëmarrja e tyre në këtë drejtim paraqitet e vakët.

#### 4.2.2. Psikologu

- **Trajnime të akredituara nga Urdhri i Psikologut**

Trajnimet që ofrohen nga MASR apo organizata të tjera është e nevojshme të akreditohen nga Urdhri i Psikologut. Akreditimi shërben si një garanci për cilësinë e trajnimeve si dhe

ndihmon psikologët në plotësimin e krediteve të detyrueshme për efekt të rilicencimit. Bashkërendimi i trajnimeve përmes UP garanton po ashtu, edhe përgatitjen e një harte nevojash, trajnimesh, kapacitetesh të disponueshme dhe maksimalizon aksesin në to.

- **Trajnimi i psikologëve në lidhje me aftësitë plotësuese dhe ndihmëse të funksioneve të tyre**

Të tilla trajnime përfshijnë:

- a) trajnime për kuadrin ligjor në të cilin psikologu shkollor ushtron rolin e tij si dhe çështje specifike të praktikës profesionale që lidhen me aspekte ligjore (substancat, kriminaliteti, referimi, etj.). Roli i psikologut shkollor bëhet më i lehtë dhe më i qartë kur ai njihet me Rregulloren e sistemit parauniversitar, manualët në ndihmë të psikologut shkollor, udhëzimet e MASR, rregulloret dhe aktet e Urdhrit të Psikologut, Kodin e Etikës dhe Deontologjisë dhe legjislacionin për mbrojtjen e të miturve, etj. Të gjitha këto i shërbejnë psikologut të shkollës që të punojë sa më i qetë duke njohur kufijtë e punës së tij dhe duke mësuar dhe të tjerët me to gjatë punës;
  - b) përdorimin e teknologjisë në funksion të një praktike bashkëkohore dhe cilësore;
  - c) zgjidhjen dhe menaxhimin e konflikteve (midis nxënësve, nxënës-mësues, prind-nxënës, prind-mësues, etj.).
- **Vendosja dhe konsolidimi i një marrëdhënie bashkëpunimi të qëndrueshëm mes autoriteteve qendrore dhe vendore të arsimit dhe Urdhrit të Psikologut**

Siç është përmendur edhe në pika të tjera përgjatë këtij raporti, Urdhri i Psikologut është evidentuar nga psikologët shkollorë si një nga aktorët kryesorë në fuqizimin, mbrojtjen dhe edukimin e vazhduar të psikologëve. Bashkëpunimi me UP mund të mundësojë:

- a) koordinimin e përpjekjeve për marrjen e krediteve, gjë që përbën sfidë për psikologët shkollorë, kryesisht në terma financiarë;
- b) koordinimin e përpjekjeve për të garantuar trajnime cilësore dhe të bazuara në praktikë;
- c) ndërmjetësimin midis psikologëve shkollorë dhe autoriteteve arsimore.

### **4.3. Sugjerime të profesionistëve lidhur me kapërcimin e sfidave/ vështirësive të lidhura me problematikën e punës së përditshme**

#### **4.3.1. Punonjësi social**

- **Iniciativa për përcaktimin e statusit të punonjësit social në institucionet e arsimit**



Duke qenë se punonjësi social është pjesë e profesioneve të rregulluara, paraqitet e nevojshme edhe rregullimi dhe profilizimi i tij në fusha të caktuara të praktikës së punës sociale, përfshirë institucionet e arsimit. Për këtë mund të identifikohen dhe të përshtaten praktika dhe modele brenda dhe jashtë vendit, të cilat do të kenë si synim kryesor mbrojtjen e tyre nga rreziku, abuzimi dhe kërcënimi. Shpesh punonjësit socialë përballen me të rinj dhe familje me probleme, me nevojën për të bashkëpunuar dhe bashkërenduar marrëdhëniet me institucione dhe aktorë të tjerë jashtë institucionit, si ato të qeverisjes vendore, shëndetësisë, drejtësisë, etj. Kjo kërkon një bazë ligjore dhe rregullatore për të bërë të mundur lidhjen e marrëdhënies dhe bashkëpunimit. Duhet të përcaktohet, zbatohet dhe respektohet numri i punonjësve socialë për shkolla dhe numër nxënësish si dhe trajtimi i veçantë në rastet kur kanë disa shkolla dhe kur ato janë të shpërndara gjeografikisht. Punonjësit socialë të trajtohen si punonjës të arsimit dhe jo si personel administrativ, gjë e cila ndikon në kategorinë e pagës, lejen vjetore dhe elementë të tjerë.

- **Përmirësimi i kushteve dhe politikave të punës**

Sigurimi i mjediseve dhe mjeteve të punës për të bërë të mundur zhvillimin e proceseve dhe aktiviteteve rutinë të praktikës profesionale. Përcaktimi dhe ndarja e qartë e roleve dhe varësisë ndërmjet profesionistëve në shkolla, qartësimi se kush duhet të bëjë çfarë dhe cili është përgjegjës për procese të caktuara. Hartimi i udhëzimeve dhe protokolleve të qarta të punës (për identifikimin, vlerësimin, ndërhyrjen sipas grupeve dhe fushave që janë parashtruar më lart) të cilat mundësojnë kryerjen e proceseve të punës, garantojnë cilësinë e shërbimeve, shërbejnë si mjete për monitorimin dhe vlerësimin dhe krijimin e bazës së të dhënave. Aksesi në informacionin mbi ndryshimet ligjore, planet e reja, hartën e shërbimeve sociale qendrore dhe vendore, zhvillimin e trajnimeve, etj. Përgatitja dhe posedimi i një dosjeje (elektronike dhe në letër) me të gjitha dokumentet ligjore si ligje, VKM, udhëzime, plane strategjike, plane vendore, etj. Përgatitja dhe posedimi i dosjes së punës (elektronike dhe në letër) me të gjitha manualët, protokollët, udhërrëfyesit, etj.

- **Të punuarit në ekip shumëdisiplinor**

Zhvillimi i seminareve, trajnimeve të përbashkëta me profesionistët e tjerë në shkolla (drejtues, mësues, punonjës socialë, psikologë, mësues ndihmës, oficerë të sigurisë) për të njohur dhe sqaruar rolet, funksionet dhe detyrat e secilit profesionist, theksuar rëndësinë e njohjes dhe respektimit të kompetencave dhe aftësive të anëtarëve të ndryshëm në një ekip shumëdisiplinor, rëndësinë e punës në ekip, etj, dhe zhvillimi i trajnimeve me pjesëmarrës nga disiplina të ndryshme sidomos për tema si menaxhimi i rastit, aftësia e kufizuar, ndërtimi i marrëdhënieve, bullizmi, ekstremizmi i dhunshëm, menaxhimi i ankthit, etj. Kjo do të mundësojë të kuptuarit dhe të punuarit e njëjtë për shumë çështje dhe praktika profesionale.

- **Ngritja e urdhrit profesional**

Ngritja e urdhrit të punonjësit social vlerësohet si një parakusht shumë i rëndësishëm për forcimin e identitetit profesional dhe garantimin e cilësisë së shërbimeve nga profesionistët. Gjithashtu, urdhri parashikohet të shërbejë si një katalizator për bashkëpunimin ndërsektorial dhe për të lehtësuar angazhimin e koordinimin e profesionistëve për të lobuar dhe advokuar për çështje me interes për ta dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre. Nëpërmjet urdhrit, punonjësit socialë në shkolla mund të organizojnë sesionet e tyre informative dhe të zhvillojnë aktivitete dhe strategji ndërhyrje për të përmirësuar performancën dhe për të zgjidhur në mënyrë të unifikuar çështje të ndryshme.

#### **4.3.2. Psikologu**

- **Lobimi për njohjen e statusit të psikologut në arsim**

Përcaktimi dhe njohja e statusit të veçantë të psikologut në arsim, garanton zgjidhjen e një sërë problemesh të lidhura me specifikimin e rolit dhe funksioneve të psikologut, shmangien e abuzimeve potenciale nga drejtuesit, mbrojtjen me ligj në rastet e përfshirjes në çështjet e kriminalitetit të të miturve, trafikimit, shpërndarjes së narkotikëve ose çështje të tjera me implikime ligjore, trajtimin financiar (paga, leja e zakonshme, mbulimi i transportit apo shpenzimeve plotësuese, mbulimi i shpenzimeve për trajnime, etj.), përcaktimin e institucioneve nga do të varen, etj.

- **Bashkërendimi i përpjekjeve institucionale për financimin dhe mbështetjen organizative të validimit dhe standardizimit të paketave të vlerësimit psikologjik**

Këto paketa duhet të përfshijnë:

- a) paketa për vlerësimin e proceseve konjitive dhe vështirësive të të nxënit;
- b) paketa për vlerësimin e aftësisë së kufizuar;
- c) paketa për vlerësimin e statusit të shëndetit mendor;
- d) paketa për vlerësimin dhe orientimin profesional.

- **Krijimi i një databaze shërbimesh në nivel kombëtar**

Databaza mund të përmbajë të gjitha shërbimet publike për fëmijë dhe adoleshentë, në nivel kombëtar si dhe një listë me shërbime të verifikuara, të ofruara në mënyrë private, përmes shoqatave apo organizatave, të cilat garantojnë cilësi dhe siguri në shërbimet që mbulojnë.

- **Edukimi i vazhdueshëm i stafit dhe nxënësve në lidhje me shërbimin e psikologut në shkollë**

Këto aktivitete duhet të jenë pjesë e pandashme e punës së psikologëve në shkolla dhe duhet të përfshihen në planet e punës. Përtej aktiviteteve informuese, mbetet përgjegjësi e psikologut që duke respektuar rolin e tij dhe duke u edukuar në vazhdim, të kontribuojë në eliminimin e konfuzioneve dhe në ndërtimin e një profili të qartë të rolit të psikologut në shkollë. Psikologët bien shpesh pre e presioneve dhe kërkesave konfuze, duke kontribuar në ruajtjen e një imazhi të paqartë mbi rolin e psikologut në shkollë.

- **Edukimi dhe kualifikimi i mësuesve dhe mësuesve ndihmës**

Sot, arsimi bashkëkohor po e vendos theksin tek nevoja për mësues të informuar në lidhje me traumat (trauma informed teachers) të cilët jo vetëm nuk bëhen pengesë në punën e psikologut shkollor përmes paragjytimeve, shmangieve apo mungesës së bashkëpunimit, por në të kundërt, kthehen në bashkëpunëtorë të ngushtë në evidentimin e problematikave të caktuara, vlerësimin e nxënësve, monitorimin gjatë orëve dhe aktivitetit mësimor dhe zbatimin e planeve të trajtimit.

#### 4.4. Sugjerime të profesionistëve lidhur me aftësimin e tyre profesional

##### 4.4.1. Punonjësi social

Ngritja e regjistrit të punonjësve socialë në shkolla me të dhëna sipas rajoneve, numrit dhe llojit të shkollave, kontaktet e tyre (telefon, adresë, e-mail, etj.) dhe vitet e punës në tërësi dhe në shkollë në veçanti. Për secilin të mbahen të dhëna për numrin e trajnimeve në të cilat kanë marrë pjesë, datën kur kanë marrë pjesë, temën përkatëse, etj. Për sigurimin e këtij informacioni mund të disenjohet një instrument që të synojë mbledhjen e të dhënave për kompetencat, njohuritë dhe aftësitë sipas fushave dhe niveleve që duhet të kenë punonjësit socialë. Bazuar mbi këtë regjistër, të ndërtohet një plan trajnimi vjetor me tema dhe shpërndarje sipas nevojës.

Gjithsesi, një grup temash trajnimi dhe organizatat që mund t'i ofrojnë ato, janë listuar më sipër.

Trajnimet nevojitet të jenë të njësuara dhe të japin informacion të përditësuar dhe nga burime të njohura. Procesi i organizimit, zhvillimit dhe njohjes së trajnimit të përmbushë standardet e nevojshme sipas qëllimit dhe ndikimit të ndërhyrjes.

Ofrimi i supervizimit profesional si nga supervizorët pranë institucionit ashtu edhe nga supervizorë jashtë institucionit për tema apo çështje specifike. Këto mund të ofrohen nga individë, ekspertë të pavarur apo organizata me përvojë në fushën përkatëse.

Pajisja e punonjësve socialë me një listë librash, tekstesh, manualesh, lidhjesh në ueb, platformash online të njohura dhe profesionale që mund t'i përdorin si burim literature dhe informacioni.

Organizimi dhe pjesëmarrja aktive në konferenca profesionale me fokus shkollat, ku ekspertë shqiptarë dhe të huaj të ndajnë përvoja dhe praktika të suksesshme, teknika të reja ndërhyrje, por edhe sfidat dhe vështirësitë kryesore si dhe të formulojnë ide për zgjidhjen e tyre.

#### 4.4.2. Psikologu

- **Supervizimi i praktikës profesionale**

Supervizimi është një praktikë që garanton cilësinë e shërbimit dhe mirëqenien psikologjike të profesionistëve në fushën e shërbimeve psiko-sociale. Supervizimi mund të fokusohet tek çështjet teknike që psikologët hasin gjatë punës së tyre dhe të shërbejë si një lloj udhëzuesi për ta. Ai mundet po ashtu, të fokusohet tek sfidat subjektive dhe emocionale që përjetojnë profesionistët gjatë ushtrimit të profesionit, në role specifike dhe që mund të ndikojnë në cilësinë e ushtrimit të rolit dhe në mirëqenien e profesionistëve. Një praktikë e balancuar, zakonisht i mbulon të dyja funksionet. Supervizimi mund të ofrohet nga institucionet e varësisë përmes:

- a) aktivizimit të resurseve të ekspertizës së disponueshme pranë institucionit;
- b) duke kontraktuar ekspertë të jashtëm;
- c) duke inkurajuar supervizimin privat, i cili mbulohet me shpenzime personale. Në këtë pikë, një praktikë e rekomanduar nga psikologët është që të lidhet një marrëveshje me Urdhrin e Psikologut me qëllim që orët e supervizimit të njihen dhe të konvertohen në kredite;
- d) organizimit dhe krijimit të kushteve për intervizion, që konsiston në takime periodike midis psikologëve shkollorë të qyteteve apo rajoneve të ndryshme dhe ku diskutohen raste, çështje, sfida, informacione dhe zgjidhje.

- **Ofrimi dhe ndjekja e trajnimeve cilësore**

Psikologët shprehin nevojën për t'u mbështetur në procesin e kualifikimi dhe edukimit të vazhduar përmes mundësisit të dhënies së lejes nga institucioni dhe njohjes së ditëve të trajnimit si ditë pune. Po ashtu, ata evidentuan një sërë tematikash dhe çështjesh specifike të cilat hasen gjerësisht në punën e tyre të përditshme dhe që kërkojnë vëmendje të veçantë përmes trajnimeve specifike dhe të mbështetura në praktikë. Të tilla tematika përfshijnë:

- njohjen, kuptimin dhe punën specifike me rastet e abuzimit seksual;
- njohjen, kuptimin dhe punën me nxënësit në rrezik për vetëvrasje;

- parandalimin, evidentimin dhe punën në rastet e bullizmit (viktima dhe bulluesi);
  - dhunën në familje;
  - trajtimin e çështjeve të seksualitetit dhe homoseksualitetit tek fëmijët me aftësi të kufizuara;
  - trajnimin në lidhje me administrimin, pikëzimin dhe interpretimin e testeve psikologjike dhe vlerësimit psikologjik në lidhje me vështirësitë e të nxënit, kujtesën dhe proceset konjitive, disleksinë, aftësitë sociale, vetëvlerësimin, stresin, ankthin, depresionin, statusin mendor, inteligjencën, etj.;
  - trajnimin në lidhje me hartimin e programeve specifike për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe monitorimin e ecurisë së tyre.
- **Përfshirja e ekspertëve dhe organizatave që garantojnë cilësi dhe përvojë të bazuar në praktikë**

Psikologët raportojnë se në shumë raste, trajnimet që u janë ofruar, nuk kanë përmbushur standardet e nevojshme të cilësisë dhe lidhjes mes teorisë dhe praktikës. Kur u pyetën në mënyrë specifike dhe nominale, psikologët raportuan se aktorët nga të cilët do të dëshironin trajnime në vijim janë:

- a) organizata me përvojë në terren dhe në ofrimin e trajnimeve si Tdh, Save the Children;
- b) institucione të arsimit të lartë universitar dhe pasuniversitar si Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, ose universitete të huaja apo programe me profil ndërkombëtar;
- c) Urdhri i Psikologut;
- d) ekspertë të përmendur nominalisht, të cilët vijnë nga praktika e drejtpërdrejtë profesionale, të tillë si Milika Dhamo, Anila Sulstarova dhe Florian Kulla në çështjet e zhvillimit të fëmijëve dhe vështirësive të të nxënit, Adem Tamo dhe Skerdi Zahaj në çështjet e kuptimit dhe trajtimit të traumave në kontekstin shkollor, Artemisi Shehu në çështjet e kuptimit të kompetencave dhe aftësive të psikologëve shkollorë dhe Blerta Bodinaku në çështjet e vlerësimit psikometrik dhe këshillimit individual/ në grup;
- e) ekspertë ndërkombëtarë me përvojë në çështjet e psikologjisë shkollore.

## 5. REKOMANDIME

Pavarësisht se i gjithë raporti është shkruar thjesht duke përcjellë në mënyrë të qartë nevojat për ndërhyrje të mëtejshme për të ndihmuar punonjësit e njësisë psiko-sociale në punën e tyre, kjo pjesë do të synojë të sjellë shkurtimisht pikat kryesore, të cilat rezultojnë të përbashkëta në nevojat e paraqitura nga rreth 130 profesionistët që morën pjesë në grupet e fokusuara të diskutimit. Për secilën nga pikat e përmendura në këtë pjesë, përgjatë raportit është dhënë informacion i detajuar dhe i mjaftueshëm për të lehtësuar hartimin e një plani bazë ndërhyrjeje në të ardhmen.

Nevojat për ndihmë të paraqitura nga punonjësit e njësive psiko-sociale janë organizuar në dy kategori kryesore si më poshtë:

1. nevojat për të trajtuar paqartësitë dhe konfuzionin që ekziston në kryerjen e roleve të psikologut dhe të punonjësit social në shkolla përmes lehtësimit të komunikimit formal dhe jo formal mes tyre (psikolog-punonjës social), mes tyre dhe bashkëpunëtorëve/ aktorëve të tjerë në shkolla, mes tyre dhe institucioneve të tjera (shëndetësi, polici, etj.), mes tyre dhe nxënësve, prindërve apo edhe anëtarëve të tjerë të komunitetit;
2. fuqizimi i roleve të tyre përmes:
  - ofrimit të mjeteve të punës (protokolle, manuale, akte ligjore, instrumente vlerësuese, formate të standardizuara raportimi, etj.), të shoqëruara me orientime dhe sqarime lidhur me përdorimin e tyre;
  - mundësit të pjesëmarrjes në aktivitete që ndihmojnë në kualifikimin e tyre (seminare, trajnime, supervizim/intervizim, konferenca kombëtare e ndërkombëtare, vizita për shkëmbime eksperiencash, etj.);
  - anëtarësimin në një Urdhër profesional i cili ju jep një status dinjitoz mes profesioneve të tjera, që i mbron nga pasiguritë e lidhura me punën dhe ju jep një zë për lobim apo advokim;
  - mundësit të kushteve dinjitoze të punës për realizimin e detyrave të profesionit të tyre (mjedise/dhomë, rimbursim transporti, komunikim telefonik, internet, mjete didaktike, kompjuter, printer, etj.);
  - pajisjes me statusin e punonjësit të arsimit gjë e cila mundëson përfitime të domosdoshme për realizimin cilësor të detyrave dhe shmangien e lodhjes profesionale.